

## Redi Jupi: Turneu European U-17 perseri ne Shqiperi

nga AlbaniaSoccer

E premte, 29 Nentor 2013 00:06

---



Redi Jupi, drejtori i ekipeve kombetare ne FSHF ka qene i derguari ne shortin per skuadrat e moshave qe eshte hedhur ne Nion te Zvicres. Shqiperia do te kete serish rastin te organizoje eliminoret ne Shqiperi, nje tjeter shanc qe i jepet vendit tone dhe skuadres se 17 vjecareve. “Kemi patur serish nje mundesi te mire dhe kjo fale fatit per shortin qe percaktoi vendin se ku do te luheshin ndeshjet eliminatore”, ka thene Jupi. Kundershtaret e Shqiperise ne kete eliminatore do te jene Austria, Norvegjia dhe San Marino. Ndeshjet do te zhvillohen ne vendin tone ne datat 8, 10 dhe 13 tetor te vitit 2014.